



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE**  
**PA1 Nr.08-218**  
**08.08.2024**  
**Shkup**

Në pajtim me nenin 18, paragrafi (1) nënparagrafi 20, nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i konsoliduar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, Vendimin PA1 nr.08-204 datë 24.7.2024, për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, PA1 nr.08-816 datë 7.9.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3384/4 datë 7.8.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 32-të mbajtur më 7.8.2024 miratoi:

**Aktvendim**  
**për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve**

1. Shoqëria Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP - Strumicë FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve.
2. Ky aktvendim botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në ueb-faqen e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

**A r s y e t i m**

Në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), leja për transmetim televiziv ose radio ndalon të vlejë sipas fuqisë ligjore, me heqjen e lejes nga ana e Agjencisë. Në pajtim me paragrafin (2) sipas nenit të cituar të ligjit, Agjencia do të fshijë radiodifuzerin nga regjistri i radiodifuzerëve derisa leja të shfuqizohet në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në vazhdimin e parë të seancës së 30-të mbajtur më 24.07.2024, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-3159/2 datë 24.07.2024, miratoi Vendim PA1 nr.08-204 datë 24.07.2024 me të cilin i hiqet leja Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, PA1 nr.08-816 datë 7.9.2023, sepse pas dhënies së lejes u krijuan rrethana që paraqesin pengesa ligjore për poseduesin e lejes për të ushtruar veprimtarinë, përkatësisht për shkak se radiodifuzeri nuk i ka përmbushur kushtet minimale kadrovike (të personelit) të përcaktuara

në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike të lejes së dhënë për transmetim në radio dhe televizion (Tekst i konsoliduar) ark.nr.01-3953/1 datë 31.10.2023, nuk ka paguar kompensim vjetor për lejen e transmetimit televiziv në afatin e përcaktuar ligjor prej – 30 ditësh nga dita e pranimit të Faturës me nr.2024-100-0148 datë 30.5.2024 (nr ynë.ark.05-2565/1 datë 30.5.2024).

Rrjedhimisht, nga sa u tha më sipër, dhe në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe neni 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë (Tekst i konsoliduar), Vendimin PA1 nr.08-204 datë 24.07.2024, për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, PA1 nr.08-816 datë 7.9.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3384/4 datë 7.8.2024, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 32-të mbajtur më 7.8.2024, miratoi aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.